



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2019:105635  
Datë: 11.03.2024  
Numri i dokumentit: 05435169

**C.nr.749/19**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm** gjyqtari Shaban Shala, me sekretaren juridike F.B. duke vendosur në çështjen juridike civile të paditësit E.Sh. nga Prizreni të cilin e përfaqëson av.M.Q. nga Prizreni kundër të paditues BKS, me seli në Prishtinë për shkak të kompensimit të dëmit, vlera kontestit 3.100 €, më datën 11.03.2024, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**NË BAZË TË HEQJES DORË NGA KËRKESË PADIA**

**I. REFUZHET si e pa bazuar** kërkesë padia e **paditësit E.Sh. nga Prizreni**, të cilën e përfaqëson av.M.Q. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura B.K.S. me seli në Prishtinë, që paditësit t'ia kompenzon të gjitha format e dëmit material dhe jo material për shkak të lëndimeve trupore të cilat rrjedhin nga aksidenti i dt.12.02.2019 më kamat ligjore duke llogaritur nga data e paraqitjes së padisë deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

**II.** Secila pale i bart shpenzimet procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësi E.Sh. nga Prizreni të cilin e përfaqëson av.M.Q. nga Prizreni në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditues BKS, me seli në Prishtinë për shkak të kompensimit të dëmit, vlera kontestit 3.100 €.

I autorizuari i paditësit av.M.Q. më parashtrësën e dt.07.03.2024 ka deklaruar se heqë dorë nga kërkesë padia lidhur më këtë çështje kontestuese sepse palët kanë lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore për të gjitha format e dëmit material dhe jo material.

Prandaj gjykata në bazë dispozitave të nenit 149 të LPK-së ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Lidhur me shpenzimet e procedurës u vendos në bazë të nenit 450 të LPK.

Numri i lëndës: 2019:105635

Datë: 11.03.2024

Numri i dokumentit: 05435169

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**-Departamenti i përgjithshëm-**  
**C.nr.749/19, dt.11.03.2024**

**Sekretare juridike**  
**Feriha Brando**

**Gjyqtari,**  
**Shaban Shala**

**KËSHILLË JURIDIKE:** kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejt ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit nëpërmjet kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.